

- Të tjerët që jetojnë në shtëpi me ju janë në rrezik. Tregojuni të gjithëve që jetojnë me ju se duhet të vizitohen nga mjeku i tyre për të bërë analizën e gjakut dhe vaksinimin.
- Nëse shfaqni infeksion kronik të hepatitit B, tregojini çdo partneri të ri seksual dhe çdo personi të ri që jeton me ju, se ata duhet të testohen dhe të vaksinohen.
- Nëse jeni shtatzënë, foshnja e re duhet të marrë vaksinën dhe imunoglobulinën e hepatitit B (HBIG) menjëherë pas lindjes.
- Nëse dikush është i ekspozuar ndaj gjakut tuaj, ai mund të mbrohet nga hepatiti B nëse mjekohet shpejt. Ai/ajo duhet të paraqitet te mjeku i tij/saj ose në urgjencë dhe të thonë se kanë qenë në kontakt me dikë me hepatitin B. Ata do të injektohen me imunoglobulinën e hepatitit B (HBIG) dhe do të fillojnë fazën e vaksinimit kundër hepatitit B.
- Tregojini mjekut dhe dentistit tuaj se jeni me hepatit B.

Si mund ta mbroj fëmijën tim nga hepatiti B nëse jam shtatzënë?

Nëse mbeteni shtatzënë, foshnja juaj rrezikon të infektohet me hepatitin B nga ju gjatë ose menjëherë pas lindjes. Kjo mund të parandalohet.

- Fëmija juaj duhet të injektohet me imunoglobulinën e hepatitit B (HBIG) dhe me dozën e parë të vaksinës së hepatitit B menjëherë pas lindjes.
- Sigurohuni që foshnja juaj të përfundojë fazën e vaksinimit kundër hepatitit B në kohën e duhur. Duhet të bëhet analiza e gjakut në përfundim të fazës së vaksinimit kundër hepatitit B për t'u siguruar që foshnja të jetë e mbrojtur

Ju nuk mund ta përhapni hepatitin B nga:

- Teshtima ose kolla
- Puthjet ose përqaftimet
- Të ushqyerit me gji
- Ushqimi ose uji
- Përdorimi i enëve dhe gotave të njëjta
- Kontakte të rastësishme (si në punë)

Mos harroni:

Këshillojini personat e afërt se duhet të vaksinohen.

Përdorni prezervativë gjatë aktit seksual për të mbrojtur partnerin dhe veten tuaj.

Si mund të informohem më shumë?

Informacione të nevojshme për hepatitin B mund të merrni nga:

- Mjeku juaj i familjes
- Zyra lokale e shëndetit publik të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (HSE)

Mund të gjeni broshura të tjera mbi hepatitin B në faqet e mëposhtme të internetit:

- www.hpsc.ie
- www.cdc.gov/hepatitis/hbv
- www.who.int
- www.immunisation.ie



Data e publikimi: Prill 2017

Autorët: Grupi i punës për sëmundjen e hepatitit të Grupit të sëmundjeve transmetuese të mjekësisë publike, Departamenti i Shëndetit Publik dhe Qendra e Mbikëqyrjes së Mbrojtjes së Shëndetit, Drejtorja e Shërbimeve Shëndetësore.



Hepatitis B

Çfarë duhet të dini nëse jeni diagnostikuar me infeksion kronik të hepatit B



Çfarë është hepatiti B?

Hepatiti B është një virus që prek mëlçinë dhe që mund të sëmurëni rëndë. Që simptomat të jenë të dukshme do të duhen nga gjashtë javë deri në gjashtë muaj nga momenti i infektimit. Kjo fazë e sëmundjes quhet hepatiti akut B. Disa njerëz me hepatiti akut B nuk shfaqin asnjë simptomë. Nëse keni simptoma, këto mund të përfshijnë: ethe, të përziera, lodhje, dhimbje, verdhëz (lëkurë dhe sy të verdhë) dhe urinë me ngjyrë të errët.

Shumica e njerëzve me hepatiti akut B shërohen plotësisht, por mund të duhet deri në gjashtë muaj ose edhe më shumë.

Disa njerëz nuk ndihen mirë, por virusi mund të vazhdojë të qëndrojë në gjakun e tyre. Ky quhet hepatiti kronik B. Një numër i vogël njerëzish sëmurën rëndë dhe mund të kenë dëmtim të mëlçisë ose probleme afatgjata të mëlçisë.

Çfarë është hepatiti kronik B?

Te disa njerëz virusi nuk zhduket kurrë. Ju mund të jeni të infektuar për gjithë jetën dhe mund ta përhapni hepatitin B te të tjerët. Ky është infeksion kronik i hepatitit B dhe njerëzit që janë të infektuar mund të infektojnë të tjerët.

Ju mund të ndiheni të shëndetshëm për gjithë jetën tuaj dhe të mos shfaqni simptoma të dëmtimit të mëlçisë. Disa njerëz sëmurën rëndë nga mëlçia si fibroza e mëlçisë (cirozë), dëmtim i mëlçisë ose kancer. Nëse jeni me hepatiti B, prapë mund të infektoheni edhe me lloje të tjera të hepatitit si ai A ose C.

A ka kurim për hepatitin B?

Mjeku juaj duhet t'ju drejtojë te një specialist që mund t'ju ekzaminojë për sëmundje të mëlçisë dhe të zbulojë nëse ilaçet mund t'ju ndihmojnë.

Si mund të kujdesem për mëlçinë?

Është e rëndësishme që të kujdeseni për veten tuaj.

- Mos pini alkool. Alkooli mund të dëmtojë mëlçinë tuaj.
- Nëse keni infeksion kronik të hepatitit B, mjeku juaj duhet t'ju drejtojë te një specialist që mund t'ju ekzaminojë për sëmundje të mëlçisë dhe të zbulojë nëse ilaçet mund t'ju ndihmojnë.
- Vizitohuni rregullisht te mjeku juaj.
- Konsultohuni me mjekun tuaj përpara se të merrni ndonjë ilaç të ri, ilaçe pa recetë dhe bimore.

- Bëni një analizë për hepatitin C.
- Bëni vaksinën kundër hepatitit A nëse nuk jeni tashmë imun.
- Bëni vaksinën vjetore të gripit.

Si u infektova me hepatiti B?

Hepatiti B përhapet nga kontakti me gjakun ose lëngjet trupore të një personi të infektuar. Ju mund të infektoheni me hepatitin B nëse:

- Kryeni marrëdhënie seksuale me një person me hepatiti B.
- Përdorni të njëjta gjilpëra ose pajisje të tjera kur merrni drogë.
- Përdorni gjilpëra të pasterilizuara për shpimin e trupit, tatuazhet, akupunkturën, elektrolizën ose të përdorura.
- Përdorni të njëjta brisqe, furçe dhëmbësh, peshqirë, prerëse thonjsh ose çdo gjë që mund të ketë gjak ose lëngje të tjera trupore.
- Bini në kontakt me plagët ose prerjet me gjak të një personi të infektuar.
- Jeni punonjës i kujdesit shëndetësor ose person tjetër i ekspozuar ndaj gjakut ose lëngjeve të infektuara trupore.
- Jeni fëmijë i një personi me infeksion kronik të hepatitit B.

Në disa raste, është e pamundur të identifikohet një burim i caktuar infeksioni.

A mund ta përhap hepatitin B te të tjerët?

Njerëzit mund të marrin hepatitin B nga ju nëpërmjet kontaktit me gjakun, spermën ose lëngjet vaginale. Herë pas here mund të përhapet edhe nga kafshimi i njeriut. Virus mund të jetojë jashtë trupit deri në një javë.

Kontaktet tuaja si partneri, familja ose kushdo që jeton me ju, duhet të bëjë analizën e gjakut për të kontrolluar nëse ka ose jo hepatiti B.

A është e sigurt vaksina kundër hepatitit B?

Vaksina e hepatitit B është e sigurt dhe e efektshme. Partneri juaj, familja dhe kushdo që jeton me ju mund të jetë i mbrojtur nëpërmjet vaksinimit.

Vaksina zakonisht jepet në tri doza nga mjeku juaj i familjes - gjatë vizitës së parë, një muaj më vonë dhe gjashtë muaj pas vaksinimit të parë. Disa herë dozat jepen më shpejt.

Disa njerëz mund të kenë nevojë për doza shtesë të vaksinës përpara se të ndihen të mbrojtur. Një numër shumë i vogël njerëzish nuk i përgjigjen vaksinës dhe nuk janë të mbrojtur.

Si mund t'i mbroj të tjerët nga infeksioni i hepatitit B?

Ja çfarë duhet të bëni për të mbrojtur të tjerët:

- Mbuloni çdo prerje dhe plagë të hapur me leukoplast ose fashë.
- Lani duart mirë pasi të keni prekur gjak ose lëngje trupore.
- Para se t'i hidhni në kosh, fasoletat (dhe produkte të tjera) me gjak ose lëngje trupore futini në një qese.
- Pastroni vendet me gjak. Pastaj ripastroni vendin me solucion zbardhues (në një sasi me zbardhues shtoni dhjetëfishin ujë).
- Mos përdorni të njëjtat furçe dhëmbësh, brisqet, gjilpëra, limë, prerëse dhe gërshërë thonjsh, peceta ose peshqirë.
- Nëse përdorni drogë me shiringa, ndalojeni këtë ose frekuentoni një program rehabilitimi. Asnjëherë mos përdorni të njëjtën drogë, gjilpëra, shiringa, pambuk, gota uji.
- Mos dhuronit gjak, plazmë, organe, inde ose spermë.
- Ju rrezikoni të infektoni partnerin tuaj seksual me hepatiti B. Tregojini partnerit(ëve) tuaj seksual që keni hepatiti B. Ata duhet të vizitohen nga një mjek për të bërë analizën e gjakut për të ditur nëse janë infektuar. Nëse nuk janë infektuar, atëherë duhet të vaksinohen. Përdorni prezervativë, derisa partneri juaj të krijojë mbrojtje.